

## QELLIMET & MBESHTETJA

### KU JEMI

Ndërsa Drejtoria Arsimore e Filadelfias po bën përparime në fusha të tilla si rritja e numrit të shkollave me performancë të lartë duke ulur numrin e shkollave me performanca të ulëta, rritja e shkallës së diplomimit 4 – vjeçar ka shumë më tepër për të bërë Studentët e Filadelfias vazhdojnë të kenë vështirësi akademike dhe të kenë rezultate të dobëta akademike krahasuar me moshatarët e tyre në qytete të tjera. Bordi dëshiron të ndryshojë këtë dhe të përqëndrohet në mënyrë të vazhdueshme që të sigurojë që studentët të arrijnë suksese dhe të udhëheqin në një shoqëri globale

### Ku duhet të shkojmë

Bordi beson se arsimi duhet të jetë i drejtë veçanërisht në një qytet me shkallë të lartë të varfërisë dhe shkolla me shumicë studentësh me ngjyrë dhe me shumë nevoja të veçanta. Barazia arsimore do të thotë t'i japësh secilit student çfarë ata kanë nevojë për të arritur potencialin e tyre të plotë.

Për të realizuar këtë qëllim, Bordi do të përqëndrohet në mësimin e studentëve dhe sigurimin që secili fëmijë të ketë burimet e nevojshme për të arritur sukses duke:

Vendosja e qëllimeve specifike, afatgjata të arritjeve të studentëve;

Vendosja jo – akademike “mbështetëse” – kushtet e nevojshme për arritjen e suksesit nga studentët;

Mbajtja e përgjegjësive nga drejtoria dhe nga vetja jonë për arritjen e qëllimeve.



### HAPAT TONA

Bordi prezantoi këto Qëllime dhe Mbështetjet në Qershor 2020 dhe planifikon të ndajë më shumë informacion me shkollat dhe komunitetet gjatë gjithë vjeshtës përmes uebinarëve, mediave sociale, letrave, faqes sonë të internetit dhe, natyrisht në takimet tona ne do të presim reagimet, mendimet, pyetjet nga komuniteti. Bordi planifikon të votojë për miratimin e Objektivave dhe Mbështetjeve të reja në takimin e tij në Dhjetor dhe pret që Drejtoria t'i zbatojë ato duke filluar në Janar 2021.

Bordi kërkon që të gjitha komunitetet tona shkollore të bashkohen për të mbështetur këtë punë kritike.

## Qëllimet tona

Qëllimet e renditura më poshtë janë standardet që duhet të arrijmë për t'u siguruar që studentët po fitojnë mjetet dhe aftësitë akademike të nevojshme për të pasur sukses në botën e shekullit 21.



### LEXIM

**Vizioni:** Çdo student lexon në ose mbi nivelin e klasës.

**Përshkrimi:** Leximi është një aftësi themelore për sukses në shkollë, kolegji, vendin e punës dhe jetën.



### MATEMATIKE

**Vizioni:** Çdo nxënës përformon në ose mbi nivelin e klasës në matematikë.

**Përshkrimi:** Studentët kanë nevojë për një themel të fortë në matematikë në mënyrë që të kenë nivele më të larta të të mësuarit në shkollën e mesme dhe të kenë sukses në karriera të ndryshme.



### KOLEGJ DHE KARRIERE

**Vizioni:** Çdo student diplomohet dhe është i gatshëm për kolegji dhe karrierë.

**Përshkrimi:** Çdo student duhet të ketë njohuritë thelbësore akademike dhe mundësinë e përvojës që do t'i përgatisë ata për suksesin .

## Mbështetjet Tona

Arritjet e studentëve nuk ndodhin pa u siguruar studentëve kushtet që duhet të arrijnë.

**Mbështetjet e renditura më poshtë janë kushtet e domosdoshme që duhet të ekzistojnë në shkolla për të arritur qëllimet tona:**

**Çdo shkollë do të jetë një vend i sigurt, mikpritës dhe i shëndetshëm** ku studentët, personeli dhe komuniteti ynë dëshirojnë të jenë dhe të mësojnë çdo ditë. Kjo do të thotë që shkollat tona do të jenë:

- Mjedise të sigurta dhe të pastra; dhe
- Hapësira me klimë gjithëpërfshirëse që u sigurojnë studentëve qasje në mbështetje të fuqishme shoqërore, emocionale dhe shëndetësore.

**Çdo student do të ketë një arsimim** me mundësi bashkëkurrikulare në arte dhe atletikë të integruar në përvojën shkollore.

**Çdo prind dhe kujdestar do të jenë të mirëpritur** dhe inkurajuar të jenë partnerë në komunitetin shkollor të fëmijës së tyre.

**Drejtoria arsimore do të punojë për të çmontuar praktikat raciste** që pengojnë arritjet e studentëve.

